

Rregullat e përgjithshme

Me qëllim përdorimin e sallave/ambienteve të Tirana EYC 2022 – Kongresi Rinor Kombëtar për zhvillimin e aktiviteteve apo eventeve rinore të cilat organizohen në kuadër të Tirana EYC 2022, duhet të keni parasysh:*

- 1- Vetëm subjektet/entitetet që kryejnë aktivitete gjithëpërfshirëse rinore dhe në kuadër të titullit “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022” do të kenë mundësi t'i aksesojnë sallat e ofruara pranë ambienteve të Tirana EYC 2022. Për rezervimet ju lutemi të na kontaktoni 4-5 ditë pune para datës të aktivitetit.
- 2- Pasi t'ju konfirmohet kërkesa për rezervim të një prej sallave, duhet të kontaktoni me personat përgjegjës për t'u informuar në lidhje me pajisjet logjistike dhe teknike që TEYC2022 – KRK mundëson për të lehtësuar aktivitetin tuaj.
- 3- Nuk lejohet në mënyrë kategorike, konsumimi i pijeve alkoolike dhe konsumimi i duhanit brenda ambienteve tona gjatë zhvillimit të aktiviteteve/eventeve.
- 4- Është përgjegjësi e juaja të rregulloni sallën në përshtatje me zhvillimin dhe specifikat e aktivitetit tuaj pasi të jeni konsultuar me ekipin tonë të logjistikës, si dhe në përfundim të tij, të riktheni ambientin në gjëndjen e mëparëshme.
- 5- Çdo dëmtim i ambienteve fizike, paisjeve elektronike apo mjeteve të tjera logjistike në pronësi të TEYC2022 – KRK gjatë zhvillimit të aktivitetit tuaj, është përgjegjësi e juaja, në të kundërt do të aplikohen masa administrative sipas rastit.
- 6- TEYC 2022 – KRK kujdeset për mjedisin dhe synon që të mbështesë aktivitete të cilat janë miqësore ndaj ndotjeve mjedisore. Ndaj, lutemi që të merret në konsideratë mbrojtja e mjedisit për çdo aktivitet dhe veprimtari që ju realizoni në ambientet tona.
- 7- Në rast anulimi të eventit nga ana juaj ju lutemi të na lajmeroni minimalisht 24 orë para zhvillimit të aktivitetit duke kontaktuar mario.kokonozi@krk-teyc2022.al
- 8- Ju duhet të merrni aprovimin tonë paraprak në lidhje me çdo material promovues që keni ndërmend për t'u përdorur në lidhje me eventin (që mund të përfshijë postera, banera apo staf mediatik/editorial).
- 9- Infrastruktura dhe koncepti i zyrave TEYC 2022 – KRK mundësojnë që të zhvillohen ngjarje dhe evente të njëkohshme apo paralele dhe potencialisht konkurruese. Ju njoftoheni nga ne për këtë në çdo rast të nevojshme.
- 10- Bashkëngjitur këtij dokumenti, i cili do të nënshkruhet nga personi/subjekti përgjegjës, është e nevojshme të dorëzohet foto/kopje e mjetit të identifikimit (ID/Pashaportë).

*Unë i/e ashtuquajtur z/znj _____, përfaqësues i subjektit/entitetit _____ bie dakord me termat e përdorimit të sallës, për realizimin e aktivitetit në kuadër të Tirana EYC 2022.

** Të dhënat e përpunuara nga ky formular do të përdoren vetëm për qëllim menaxhimi të sallave dhe përmbushjes të objektivave logjistike dhe teknike të këtij dokumenti.

Duke ju falenderuar, lutemi në mirëkuptimin tuaj.